



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**BASHKIA KRUIJË**  
**(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

**Krujë ,më 06.11.2023**

**PROCESVERBAL – KONTRATE MALLI**  
**ME OBJEKT**

**BLERJE DRU ZJARRI DHE PELET PER NGROHJE**

**PËR ARGUMENTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR  
KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

I mbajtur sot me date 06.11.2023 ne Kruje , nga ana e Njesise se Prokurimit ngritur me urdherin nr.596 datë,06.11.2023 me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me te dhenat si vijon:

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje Dru Zjarri dhe Pelet per ngrohje .**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Dru Zjarri / (03413000-8).**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 2’080’000(dymilion e tetedhete mije ) lekë pa tvsh.**

**AFATI I LEVRIMIT/EKZEKUTIMIT TE KONTRATES: Me kerkese te AK deri me 31.12.2023 duke nisur nga data e nenshkrimit te kontrates.**

**BURIMI FINANCIMIT :TE ARDHURAT E BASHKISE KRUIJE .**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kruje ka hartuar procesverbalin për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; *(ne vleren prej 2% te fondit limit te kontrates)*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8).

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**1-a)** Operatori ekonomik nuk duhet të ketë detyrime të taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe ato të vitit 2023 të njohura nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së taksës vendore 2023 për secilin operator)*

**Shenim-**Per të përmbushur këtë kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8, ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2023 të leshuar nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë sipas QKB, në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së taksës vendore 2023 për secilin operator).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe kërkesave specifike të Ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Krujë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të

taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Per te provuar permbushjen kriterëve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesoje kerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

a) Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2020-2021-2022) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës, qe prokurohet përkatësisht ne shumen prej **832'000 (teteqind e tridhjete e dy mijë ) leke pa t.v.sh**

Shenim-Pika 2.2-a) plotesohet duke paraqitur edhe vertetimin perkates te Administrates Tatimore

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43.2.c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë neëkohe dhe në përputhje me specififikimet teknike të kerkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim,

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike

Vlera e marzhit te xhiros se kerkuar ne kufirin e percaktuar si me siper konsiderohet tregues i rendesishem per kapacitetin financiar te Operatorit Ekonomik Ofertues, duke marre ne analize edhe faktin se vlera e fondit limit eshte e nje kufiri te ulet dhe iu jep mundesine nder te tjera e dhe operateve ekonomik te vegjel dhe te mesem te kene akses ne oferte.

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

### 2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1- Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit me një vlerë jo me te vogel se 20 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht jo me pak se vlera **416'000 (katerqind e gjashtembedhjete mijë ) leke pa t.v.sh**, dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a)-për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b)-për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e Operatorit Ekonomik ofertues në ofrimin e mallrave që janë objekt prokurimi. kontraten pa vonesa dhe pengesa që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

---

Vlera në kufirin e përcaktuar në VKM nr 285 datë 19.05.2021, është përcaktuese dhe objektive, si dhe garanton AK (Bashkinë Krujë), se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie si dhe të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

### **2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**3.1-Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të marrë përsipër të furnizojë/transportojë dhe të dorëzojë mallin objekt kontrate, në vendet e përcaktuara nga ana e Bashkisë Krujë me mjetet e tij që ka në dispozicion sipas kërkesës së AK.(Deklarate të lëshuar nga Administratori i shoqërisë) brenda afatit të levrimit .**

**Argumentimi:**Kërkesat e mësipërme janë vendosur nga ana e AK në përputhje me nenin 44.2 e vijues të VKM nr 285 datë 19.05.2021 nëpërmjet të cilave kërkohet që Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron furnizime me karakteristika specifike ose specififikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës,

mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Lista e artikujve të cilët do blihen janë si vijon të detajuara me specifikimet teknike përkatëse*

	EMËRTIMI I MATERIALEVE	NJËSIA	SASIA	Afati I Levimit
1	Dru Zjarri për Ngrohje	m <sup>3</sup>	320	nga data e nënshkrimit të kontratës, deri me 31.12.2023 me kërkesë të AK
2	Pelet për ngrohje	kg	8000	

- Hartimi i specifikimeve teknike për blerjen e druve të zjarrit dhe peletit për ngrohje sipas listës së miratuar në preventivin përkatës është bërë duke iu referuar shkresës së Drejtorisë së Arsimit, Kulturës dhe Sportit nr. \_\_\_\_\_ Prot, datë 06.11.2023 duke identifikuar për çdo artikull specifikimin dhe karakteristikat përkatëse teknike të cilat plotësojnë nevojat respektive për ngrohje të institucioneve të arsimit parauniversitare publike në territorin administrativ të Bashkisë Krujë.
- Sa i përket standartit të tyre për çdo artikull ato janë hartuar duke marrë në konsideratë përcaktimet respektive sipas artikujve dhe standartit të pranuar të tregut si dhe kërkesat përkatëse të Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011, "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore". Specifikimet teknike janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.
- **III-Fondi limit** për procedurën me objekt, "Blerje Dru Zjarri dhe Pelet për ngrohje", është hartuar duke iu referuar çmimeve të tregut për kategorinë e mallrave/artikujve të ngjashëm, sipas referimeve dhe metodave të parashikuara në nenin 76.c të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik". Për këtë qëllim është administruar dokumentacioni provues përkatës.

## NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK